

# Interreg



## Balkan-Mediterranean Mo.Na



## PORTAT MONUMENTALE NË BUTRINT MONUMENTAL GATES IN BUTRINT





## Përmbajtja

- Projekti Mo.Na - Monumente në Natyrë: Një bashkëjetesë krijuese
- Përshkrim historik i qytetit antik të Butrintit
- Portat hyrëse në qytetin antik të Butrintit

Ky botim, i shtypur në 1200 kopje, nuk është në shitje. Iu shpërndahet falas të gjithë të interesuarve që vizitojnë Parkun Kombëtar të Butrintit deri në përfundim të rezervave. Fotografitë e publikuara në këtë botim janë origjinale dhe të realizuara nga institucionet e përfshira në projektin Mo.Na, si dhe institucionet mbështetëse të projektit që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij botimi.

*Mbështetja financiare për hartimin dhe publikimin e këtij materiali është siguruar nga Programi Interreg Balkan - Mediterranean 2014/2020.*

## Table of Contents

- Mo.Na Project - Monuments in Nature: A Creative Co-existence
- Historical overview of Ancient city of Butrint
- Main Gates in Ancient city of Butrint

The publication printed in 1200 copies, is not intended for sale. It shall be distributed free of charge to all interested visitors of the National Park of Butrint until the number of copies available finish. The pictures published in this publication are original and are realized from partner institutions of Mo.Na project and stakeholder institutions that have contributed to the realization of this publication.

*The preparation and printing of this publication was made possible with the financial support of Interreg Balkan - Mediterranean 2014/2020 Program*

The authors are responsible for the choice and the presentation of the facts contained in this material and do not commit the Program. The designations employed and the presentation of material throughout this brochure do not implement the expression of any opinion whatsoever on the part of this Program concerning the legal status of any country, territory, city or area, and its authorities, or concerning the delimitations of its frontiers or boundaries.

## Projekti Mo.Na – Monumente në Natyrë: Një bashkëjetesë krijuese

Projekti MoNa zbatohet në kuadër të Programit INTERREG Balkan - Mediterranean 2014-2020 dhe bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (ERDF dhe IPA II) si dhe nga Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

**Periudha e realizimit:** 2019-2021

**Partnerë:** European Centre for Byzantine and Post Byzantine Monuments (Greqi) - *Partner Lider*, Ephorate of Antiquities of Cyclades (Greqi), Municipality of Thira (Greqi), Hellenic Centre for Marine Research (Greqi), Municipality of Nessebar (Bullgari), Society of Cypriot Studies (Qipro), Department of Forests of the Ministry of Agriculture, Rural Development and Environment (Qipro).

Projekti Mo.Na, synon të analizojë dhe vlerësojë mbrojtjen dhe promovimin e burimeve natyrore dhe kulturore në të gjithë territorin Ballkan-Mesdhe, me objekt kryesor planifikimin e integruar dhe strategjitë e përbashkëta të menaxhimit të vlerave natyrore kulturore të evidentuara ndërkombëtarisht (Natura 2000, Zonat Ramsar etj.) si dhe zona të mbrojtura nga UNESCO etj.

Qëllimi i tij është të zhvillojë mjete dhe praktika të menaxhimit në sitet e përzgjedhura si raste studimore - vende me interes të lartë natyror dhe kulturor në rajonet partnere në projekt (Santorini - Greqi, Nessebar - Bullgari, Butrint - Shqipëri, Kykkos - Qipro).

### Rezultatet e Projektit Mo.Na në Shqipëri - rast studimor “Qyteti antik i Butrintit”:

- Platforma digjitale - Faqe Web: <http://www.interreg-balkanmed.eu/approved-project/45/>
- Takime teknike dhe workshop ndërkombëtar me temë “Ndërveprimi midis faktorit njerëzor, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit në kuadër të ndryshimeve klimaterike – rasti i Butrintit” (5-7 Nëntor 2019).
- Realizimi i materialeve informative mbi Qytetin antik të Butrintit.
- Aktivitete ndërgjegjësuere për moshat e reja mbi trashëgiminë mjedisore dhe kulturore “Rrugëtimi fantastik i Junia Rufinës”, (4 Tetor 2020).
- Fushata informuese, aktivitete trajnimi dhe aktivitete promovuese, të hapura për të gjithë.

## MoNa Project - Monuments in Nature: A Creative Co-existence

The project MoNa is implemented within the framework of INTERREG - Balkan - Mediterranean 2014-2020, and is co-funded by the European Union (ERDF and IPA II) and by National Funds of participating countries.

**Realization period:** 2019-2021

**Partnership:** European Centre for Byzantine and Post Byzantine Monuments (Greece) - *Lider Partner*, Ephorate of Antiquities of Cyclades (Greece), Municipality of Thira (Greece), Hellenic Centre for Marine Research (Greece), Municipality of Nessebar (Bulgaria), Society of Cypriot Studies (Cyprus).

The Project aims to record, analyze, assess and contribute towards the protection and promotion of natural resources and cultural heritage across the Balkan-Mediterranean territory. Its main goal is to enhance integrated planning and common management strategies in areas of high environmental interest and preservation value (Natura 2000, Ramsar areas etc.), where sites of high cultural importance also exist (UNESCO protected areas, etc.).

Its goal is to develop common tools and management practices; therefore, it is expected to add value to the participating regions which are considered at national level as places of high natural and cultural interest (Santorini/Greece, Nessebar/Bulgaria, Bultrint/Albania, Kykkos Forest/Cyprus).

### Results of Mo.Na Project in Albania – Case Study Ancient city of Butrint:

- Digital Platform – Web page: <http://www.interreg-balkanmed.eu/approved-project/45/>
- Technical meetings and international workshops “The changing interaction in the balance between the human factor and environment in accordance to the climate change - The case of Butrint”, (5-7 November 2019).
- Informative and promotional materials on the values of the ancient city of Butrint world property.
- Raising awareness activities, storytelling for multiple target groups on the environment and cultural heritage, “The Fantastic itinerary of Junia Rufina” (4 October 2020).
- Information campaigns, training activities and promotional activities, open to all.

- Konferencë finale: “Monumente në natyrë. Një bashkëjetesë krijuese”, (Athinë 7-9 korrik 2021).
- Hartëzimi i habitateve me qëllim përmirësimin e gjendjes së konservimit dhe për promovimin e ruajtjes së biodiversitetit në Butrint.
- Realizimi i studimeve mbi ndikimin që prania e ujërave ka në rrënojat e qytetit antik të Butrintit, Pasuri Botërore (2020).
- Trajnim mbi konservimin e mozaikëve me objekt punime konservimi në dy mozaikë në Butrint (2021).
- Punime konservimi dhe restaurimi në Portën me Kulla dhe Nymfeum – Butrint (2020-2021).
- Realizimi i brandit / markës për promovimin dhe mbrojtjen e mjedisve kulturore dhe natyrore.

Në emër të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), dhe në cilësinë e Menaxherit të projektit Mo.Na për IKTK-në, dëshiroj të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe institucionet mbështetëse në këtë projekt, të cilat kanë kontribuar edhe në hartimin e kësaj broshure mbi promovimin e Parkut Kombëtar Butrint, pasuri botërore, në veçanti: Njësinë e Administrimit dhe Koordinimit të Parkun Kombëtar Butrint, dhe komunitetin lokal që kanë qenë të interesuar dhe kanë marrë pjesë aktive në aktivitetet e realizuara në Butrint në kuadër të projektit Mo.Na.

Një falenderim i veçantë i dedikohet programit të financimit të këtij projekti, Interreg Balkan - Mediterranean 2014-2020, nëpërmjet të cilit u bë i mundur realizimi i këtij publikimi, në funksion të qëllimit të përbashkët, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë tonë kulturore materiale.

**Arta Dollani**  
**Drejtor i Përgjithshëm**  
**Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore**


- Final Conference “Monuments in Nature: A Creative Co-existence”, (Athens 7-9 July 2021).
- Habitat mapping for the promotion of biodiversity conservation in Butrint.
- A study and full understanding of the effects that the presence of water and drainage of the terrain will have on the archaeological remains of the Ancient city of Butrint, World Heritage Property, (2020).
- Training Workshop on conservation of mosaics, focused in concrete conservation actions on two particular mosaic floors Butrint, (2021).
- Conservation and restoration works on the Tower Gate and Nympheum – Butrint (2020-2021).
- Brand for the promotion and protection of natural and cultural environment.

On behalf of the National Institute of Cultural Heritage (IKTK), and as the Project Manager of Mo.Na for IKTK, I would like to thank all the collaborators and stakeholder institutions who have contributed and continue to support us in this project, as well as to the design of this publication for the promotion of the National Park of Butrint, world heritage property, in particular:

The Unit of Administration and Coordination of the National Park of Butrint, as well as the local community who have shown high interest and have actively participated in all activities carried out in Butrint in the framework of Mo.Na project.

Special thanks goes to the financing program of this project, Interreg Balkan – Mediterranean 2014-2020, through which the realization of this publication was made possible in view of the common goal, protection and promotion of our tangible cultural heritage.

**Arta Dollani**  
**Director General**  
**National Institute for Cultural Heritage**



## Panoramë historike e Qytetit Antik të Butrintit

### **Butrinti**

Butrinti, ndodhet në një kodër në jug të Shqipërisë, afërsisht 20 km nga qyteti i Sarandës, dhe rrethohet nga ujërat e Liqenit të Butrintit, me pamje nga Kanali i Vivari. Ai përbën një peizazh të jashtëzakonshëm që ndërthur monumentet dhe rrënojat arkeologjike në sfondin e një territori ballkano-mesdhetar. Qyteti antik i Butrintit u përfshi në listën kombëtare të trashëgimisë si monument kulture në vitin 1948. Butrint u shpall “Pasuri Botërore e mbrojtur nga UNESCO” në vitin 1992 bazuar në Kriterin kulturor (iii) si: “... një sit që ofron vlera të qytetërimit në antikitetit dhe mesjetë në territorin e Shqipërisë”.

Prona Pasuri Botërore e Butrintit u zgjerua në vitin 1999. Rëndësia natyrore e Ligatinave të Butrintit u njoh nga Konventa Ramsar në vitin 2002. Në vitin 2005, bazuar në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, Butrint u shpall Park Kombëtar. Parku Kombëtar vepron si një zonë mbrojtëse për pronën e Trashëgimisë Botërore. Aktualisht, mbrojtja dhe konservimi i monumenteve arkeologjike sigurohet nga ligji 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Arkeologjisë janë përgjegjës për të gjitha kërkimet, gërmimet dhe konservimin e rrënojave arkitektonike dhe arkeologjike.

## Historical Overview of Ancient city of Butrint

### **Butrint**

Butrint, located on a hill in south Albania, approximately 20km from the modern city of Saranda, is surrounded by the waters of Lake Butrint and overlooking the Vivari Channel. It constitutes an exceptional landscape that combines archaeological finds and monuments against the backdrop of a Balkan-Mediterranean territory. The ancient city of Butrint was included in the National Heritage List of Protected Monuments in 1948. Butrint was listed as a UNESCO World Heritage Site in 1992 based on cultural Criterion (iii) as: “...a site that provides valuable evidence of ancient and

medieval civilizations on the territory of modern Albania”. The World Heritage property was extended in 1999. The natural significance of Butrint Wetlands were recognized by the Ramsar Convention in 2002. In 2005, based on the Law on Protected Areas, Butrint was declared a National Park. The National Park acts as a buffer zone for the World Heritage property. Currently, the protection and conservation of the archaeological monuments is provided by the national Law on Cultural Heritage and Museums. The National Institute of Cultural Heritage and the Institute of Archaeology are responsible for all research, excavations, and conservation of architectural and archaeological remains.

## BUTRINTI: PANORAMË HISTORIKE

### Origjina dhe qyteti

Butrinti (Buthrotum në Antikitet) ishte një qendër e rëndësishme e Antikitetit. Muret fortifikuese dhe monumentet e qytetit mbartin dëshmi të shumta të fazave të ndryshme të ndërtimit të tyre, ndërsa të dhënat arkeologjike përfaqësojnë çdo periudhë të historisë dhe zhvillimit të qytetit, deri në shek. XIX.

Bazuar në të dhënat arkeologjike, vendbanimi më i hershëm në Butrint shtrihej në kodrën e ulët të akropolit: bëhej fjalë për një vendbanim të vogël të fundit të epokës së bronzit. Me shumë gjasë vendbanimi më i hershëm duhet të ketë qenë i fortifikuar dhe ndoshta me të lidhet edhe një faltore e vogël, e cila do të lulëzojë në shekujt e mëvonshëm.

### Butrinti Korkyras, Kaon dhe Prasaib (shek. VII – II p. Kr.)

I vendosur në fund të gadishullit të Ksamilit, Butrinti përfaqësonte një qendër të privilegjuar të Antikitetit, me një pozicion mjaft të favorizuar, në afërsi të një prej rrugëve më të rëndësishme detare të kohës, çka përbënte një stimul të rëndësishëm në zhvillim ekonomik dhe social të qytetit. Qyteti u banua në mënyrë të vazhdueshme, nga prehistoria, dhe u themelua si një qendër e fortifikuar në shek. VII p. Kr. Ai përmendet për herë të parë nga gjeografi grek Hekateu i Miletit, në shek. VI p. Kr. Gjatë kësaj periudhe, Butrinti ishte një lloj akropoli me sipërfaqe të vogël, nën kontrollin e Korkyrës (Korfuzit), një emporion, që i shërbente lidhjeve tregtare me vendësit kaonë por edhe shfrytëzimit të peshkatoreve. Situata në emporionin korkyras ndryshoi tërësisht në fillim të shek. IV p. Kr, kur mbreti molos Alketa pushtoi bregdetin përballë Korkyrës, duke përfshirë edhe Kaoninë. Rreth vitit 380 p. Kr. Butrinti u transformua nga një emporion në një qendër të fortifikuar, ndërsa fortifikimi i vjetër në kodër u ruajt si akropol. Gjatë dekadave të fundit të shekullit IV p. Kr. fiset kryesore të Epirit (Molosët, Thesprotët dhe Kaonët) krijuan *Symahinë Epirote*, një aleancë ushtarake e drejtuar nga mbretërit ajakidë, por me autonomi të gjerë krahinore. Në vitin 231, monarkia në Epir u rrëzua dhe i shpall republika e njohur si Koinoni i Epirotëve. Koinoni i Prasaibëve, me qendër Butrotin, mbeti si njësi autonome e Koinonit të Epirotëve, deri në vitin 167 p. Kr. Gjatë periudhës helenistike, Butrinti arrit kulmin e tij dhe si rrjedhojë u ndërtuan vepra publike si: teatri, agoraja, muret rrethuese përreth kodrës së akropolit dhe një faltore e Asklepit në shpatin lindor.

## BUTRINT: HISTORICAL OVERVIEW

### Origins & City

Butrint (ancient name Buthrotum) was an important settlement in Antiquity. The fortifications and the monuments of this city bear testimony to the different stages of their construction, while the archaeological remains represent each period of the city development and history up to the turn of the 19th century. Archaeological excavations have revealed that the earliest settlement at Butrint was probably limited to the acropolis hill: a small nucleus of the Late Bronze Age may have occupied the saddle and the eastern hill peak. The early settlement was probably walled and might have been associated with a shrine that flourished in later centuries.

### Corcyrean, Chaonian and Prasaebean Butrint (7th – 2nd century BC)

Situated on the furthest edge of Ksamil Peninsula, Butrint was a privileged centre in Antiquity occupying a highly favourable position close to one of the most important sea routes, which provided a major stimulus for the economic and social development of the city. The city was continuously inhabited since prehistoric times and it became a site of a Greek colony. It was established as a fortified centre in the 7th century BC. It was first recorded by the Greek geographer Hecataeus of Miletus in the 6th century BC. At that time Butrint was a small acropolis under the control of Corcyra (Corfu), which emerged as an emporion, serving the commercial relations of the local population and exploiting the lake fisheries. The situation of the Corcyrean emporium of Butrint changed radically at the turn of the 4th century BC, when Molossian king Alketas invaded the coast opposite Corcyra, including Chaonia. Around 380 BC, Butrint was transformed from an emporion into a fortified city with the old fortification conserved as an acropolis. During the last decades of the 4th century BC the chief tribes of Epirus (Molossians, Thesprotians and Chaonians) created the *Symachy of Epirus*, a military alliance run by the Aeachidian kings, which rendered the region widely autonomous. Phoenice became the Chaonian capital city and Butrint the centre of Prasaebes Koinon, one of the autonomous subdivisions of the Chaonians. In 231 BC, the monarchy of Epirus was brought down and the region was declared a republic known as Epirotes' Koinon. The Prasaebes Koinon, with Butrint as its centre, remained an autonomous territory

Megjithatë, shumë shpejt rajoni do të përfshihej në luftën gjithmonë e më të dhunshme midis pushtetit në rritje të republikës romake dhe mbretërisë së Maqedonisë.

### Periudha romake

Në fillim të shek. II p. Kr., Roma kishte arritur të merrte kontrollin mbi Korfuzin dhe në vitin 168 p. Kr. dominoi Kaoninë, në kohën kur Maqedonia përfundimisht pësoi disfatë dhe territori i saj u kthye në provincë romake. Pas kësaj kohe Butrinti filloi të përfshihej gjithnjë e më tepër në politikën romake. Në vitin 44 p. Kr. pas fitores së tij mbi Pompeun, Çezari u përpoq të vendoste një koloni romake në Butrint, një plan i cili u realizua më vonë, rreth vitit 30 p. Kr. nën drejtimin e Augustit. Që nga kjo kohë, fillon një periudhë e re konstruksioni, e cila materializohet në ngritjen e shumë ndërtesave si: forumi, akuedukti dhe banjat. Rreth mesit të shek. III m. Kr., të dhënat dokumentare e lidhin qytetin e mrekullinë e Shën Terinit. Gjatë këtij shekulli, fillon një periudhë rënieje dhe një tërmet shkatërroi një pjesë të madhe të qytetit. Megjithatë, qyteti mbijetoi dhe gjatë Antikitetit të Vonë, ndonëse pësoi ndryshime të qenësishme, duke përjetuar një periudhë zgjerimi dhe lulëzimi.

### Antikiteti i Vonë dhe periudha bizantine

Në shek. V m. Kr. Butrinti del si qendër e hershme peshkopale. Qyteti i hershëm mesjetar përbënte qartazi një entitet shumë më të reduktuar, por jo krejtësisht të braktisur; vendbanimi ndoshta u tkurr si qendër në rrëzë të kodrës së akropolit dhe zonës përreth bazilikës. Në shek. IX m. Kr. dhe në shek. X m. Kr. Butrinti përbënte një qendër nën kontrollin e Perandorisë Bizantine dhe ishte një seli peshkopate në varësi të Mitropolisë së Nikopojës. Muret e qytetit u rindërtuan dhe u ndërtua edhe një mur i ri përreth linjës bregdetare dhe kanalit. Pallati peshkopal, baptisteri dhe bazilika janë dëshmi të rëndësishme të ndërtimeve të kësaj periudhe. Në vitin 1081, Butrinti u pushtua nga Normanët, nën udhëheqjen e Robert Guiskardit dhe djemve të tij. Më vonë, ai kaloi në duar të ndryshme pushtuesish, si Anzhuinët, sundimtarët e Despotatit të Epirit, të cilët përdorën Butrintin dhe qytete të tjera bregdetare si baza për sulmet e ndërmarra kundër Perandorisë Bizantine, deri në vitin 1336, kur Butrinti hyn nën sundimin e Republikës së Venedikut.

in the Epirotes' Koinon until 167 BC.

During the Hellenistic Period, Butrint reached its zenith and was enhanced with new buildings: a theatre, an agora and a circuit of defensive walls encircling the acropolis hill and the shrine of Asclepius on its southern slope. However, the entire region was soon drawn into the increasingly violent contest between the rising power of the Roman Republic and the established kingdom of Macedonia.

### Roman Period

By the early second century BC, Rome had secured control of Corfu and dominated Chaonia in 168 BC, when Macedonia was finally defeated, and its territory ultimately made into a Roman province. Thereafter, Butrint was increasingly entangled in Roman politics. In 44 BC, after his victory over Pompey, Caesar attempted to establish a colony at Butrint, a plan which came to fruition later, around 30 BC, under Augustus. From this time on, the construction of new buildings and facilities began: a forum, an aqueduct and bathhouses were planned. By mid–3rd century AD, later documentary records associate the city with the miracle of St. Therinus. During that century, Butrint started to decline and an earthquake destroyed a large part of the city. However, the settlement survived into late Antiquity, while the city underwent significant changes, experiencing a period of expansion and flourishing.

### Late Antiquity and Byzantine Period

In the 5th century AD Butrint emerges as an early Episcopal centre. The early medieval city was clearly a much – reduced entity, but not entirely abandoned; the settlement probably shrank as a hub around the foot of the acropolis and the area around the basilica. In the 9th and 10th centuries, Butrint formed an outpost of the Byzantine Empire and emerged as a Bishopric Seat under the metropolis of Nicopolis. The city walls were reconstructed and a new wall around the shoreline of the Channel was built. An Episcopal Palace, the baptistery and the basilica constitute testimonies of this period. In 1081, Butrint was seized by the Normans, under Robert Guiscard and his sons. Later, their successors, the Angevins, rulers of the Despotate of Epirus used the city and other coastal cities as bases for attacks against the Byzantine Empire, until 1386, when Butrint was purchased by the Republic of Venice.



### Shek. XVII – XIX

Në mesin e shek. XVII, qyteti i Butrintit u pushtua përkohësisht nga osmanët, një ngjarje që rezultoi me rënien e shpejtë të aktivitetit ekonomik të qytetit. Në vitin 1660, e morën përsëri Butrintin dhe ndërtuan një kullë për mbrojtjen dhe kontrollin e peshkatoreve. Sundimi venedikas zgjati deri në kolapsin e Serenissimas në vitin 1798 dhe pasoi një periudhë e shkurtër pushtimi francez në qytet. Në vitin 1799, sundimtari shqiptar Ali Pasha pushtoi Butrintin, i cili u bë pjesë e Perandorisë Osmane. Ali Pasha ndërtoi një kala të re në buzë të kanalit të Vivarit dhe kontrolloi Butrintin deri në vrasjen e tij në vitin 1822.


### 17th – 19th century

In mid-17th century the city was occupied by the Ottomans, which resulted in a rapid decline of economic activity. In 1660 the Venetians captured Butrint again and built a tower to control the lake fisheries. The Venetian rule lasted until the collapse of Serenissima in 1798 and a short period of French possession of the city followed. In 1799, the Albanian Ottoman governor Ali Pasha conquered Butrint, which became part of the Ottoman Empire. Ali Pasha constructed a new castle at the mouth of the Channel and controlled Butrint until his assassination in 1822.

### Bibliografia/References:

- Neritan Ceka, Fortifikimi antik i Butrotit dhe i territorit të Prasaibëve, Monumentet, 12, 1976.
- Gjerak Karaiskaj, Butrinti dhe fortifikimet e tij, Tiranë, 1983.
- Astrit Nanaj, Butroti protourban, Iliria, 2, 1985
- Luigi M. Ugolini, Butrinti. Miti i Eneas (translated from Italian by Zef Simoni), Instituti Italian i Kulturës, Tiranë, 2000.
- Neritan Ceka, Buthrotum (translated from Albanian by Pranvera Xhelo), Migjeni, Tirana, 2002.
- Neritan Ceka, Archaeological Treasures from Albania, Volume II, Migjeni, Tirana, 2012.

## PORTAT MONUMENTALE NË QYTETIN ANTIK TË BUTRINTIT





## PORTA E LIQENIT

Porta e Liqenit ose “Porta Skea”, e emërtuar kështu nga Misioni Arkeologjik Italian i udhëhequr nga Maria Luigi Ugolini (1928-1940), sipas përshkrimit që Virgjili i bënte portës së hyrjes së Eneas në Butrint, si dhe bazuar në identifikimin e saj nëpërmjet vendndodhjes së një kulle në të majtë të portës. Kjo është një nga portat antike më të mirëruajtura në Butrint dhe mendohet të ketë qenë në përdorim gjatë gjithë jetës së qytetit. Porta është ndërtuar në shek. IV para Krishtit dhe ka një lartësi prej 5m (nga bazamenti deri në arkitra), dhe një gjerësi prej 2.1m. Dyshemeja e shtruar, datohet në periudhën Bizantine. Porta fillimisht ka qenë e ndërtuar me blloqe guri izodomikë të punuar vetëm në faqen e jashtme, sot të dukshme në nivelin e saj më të ulët, ndërsa në nivelet më të larta dallohen rreshta gurësh më të vegjël të cilat i përkasin një faze të dytë.

## THE LAKE GATE


The Lake Gate or the “Scaean Gate” as named by the Italian Archaeological Mission led by Maria Luigi Ugolini (in 1928-1940) according to Virgil’s description of Aeneas entering Butrint and based on its identification through the location of a tower to the gate’s left. This is one of the most well-preserved ancient gates in Butrint and is thought to have been in use throughout city’s lifetime. The gate was built in the 4th century BC and is 5m high (from the ground to the architrave) while the entrance is 2.1m wide. The floor which is still visible dates back to the Byzantine period. The gate was originally built with isodomik stone blocks worked only on the outside, which are visible at its lowest level while at the highest levels it is built with rows of stones in smaller dimensions belonging to a later phase.

Seritan Ceka “Butrint: Një guidë në qytet dhe monumentet e tij”



## PORTA E LUANIT

Porta e Luanit, që datohet në shek. IV para Krishtit e merr emrin nga një relief impresionues në arkitraun e saj, që paraqet një luan duke shqyer një dem. Demi është i shtrirë përtokë, ndërsa janë të dallueshme vetëm koka dhe brirët. Porta origjinale është e tipit tangencial, me një gjerësi më të madhe sesa ajo që krijon arkitraun me luanin dhe demin. Ajo ruan të plotë korridorin antik me gjatësi 4.3m dhe lartësi 3.4m, i cili mbulohet nga arkitrarë guri të vendosur si te porta Skea / porta e Liqenit. Në shek. V pas Krishtit është bërë një rindërtim i portës nga materiale të fasadës së vetë portës, ndoshta për arsye mbrojtjeje. Punimet në këtë kohë tregojnë se hapësira e hyrjes është zvogëluar (gjerësia është ngushtuar në 1.19 m dhe lartësia është ulur në 1.5 m). Nga porta origjinale ruhen në gjendje fillestare, pa asnjë ndryshim, korridori dhe e gjithë fasada e pjesës së brendshme të saj.



## THE LION GATE

The Lion Gate, dates back to the 4th century BC. It takes its name from an impressive relief of the architrave depicting a lion tearing a bull. The bull is lying on the ground, while only the head and the horns are distinguishable. The original gate was of the tangential type, being wider and higher than the current one. It still preserves the ancient corridor with a length of 4.3m and a height of 3.4m, which is covered by stone architraves placed similarly as at the Scaean Gate / Lake Gate. During the 5th century AD, a reconstruction of the gate was undertaken using stone materials from the façade of the same gate probably for protection reasons. The works dated at this period show that the entrance space has been reduced (width has been narrowed to 1.19 m and height has been reduced to 1.5 m). The corridor and the entire façade of its interior are still preserved from the original gate.



## PORTA VERIORE

Porta Veriore është e tipit tangencial dhe ka një korridor me gjatësi 5.50m e gjerësi 2.40m. Ajo datohet në shek. IV para Krishtit, por është rikonstruktuar dhe është përdorur deri në periudhën e Mesjetës. Blloqet masivë të portës origjinale të periudhës helenistike, janë ende të dukshëm si themele të murit original të jashtëm dhe si spolia në shtesat e mëvonshme të strukturës mbrojtëse. Gurët e dalë të hyrjes origjinale, të ngjashëm me madhësinë e gurëve në portën e Liqenit, sugjerojnë një ngjashmëri strukturore midis dy portave.

## THE NORTH GATE

The Northern Gate is of tangential type, with a 5.50m long and 2.40m wide corridor. The gate dates back to the 4th century BC but was reconstructed and used until the Medieval period. The massive blocks of the original Hellenistic gate are still visible as foundations of the original external wall and used as spolia in later additions to the defensive structure. The protruding stone blocks of the original entrance, similar to the size of the stones at the Lake Gate suggest a structural similarity between the two gates.

## PORTA E UJIT

Porta e Ujit ndodhet në jugperëndim të Bazilikës së Madhe, pikërisht në breg të kanalit të Vivarit. Ajo ka qenë një hyrje e madhe dhe e mirëfortifikuar, e cila të çonte në qytet nga ana e kanalit të Vivarit dhe liqenit të Butrintit. Kjo portë përbëhet nga një ambient hyrës me plan katror, ndërsa një kullë në drejtim të ujit i ofron mbrojtje anësore nga sulmet. Porta e Ujit zëvendësoi Portën me Kulla të periudhës Helenistike dhe arritja drejt saj realizohej vetëm me varkë. Kjo portë daton në shek. VI pas Krishtit, por ka pësuar dhe ndërhyrje më vonë. Forma dhe orientimi i portës jep mundësinë e të paturit një mol të vogël në anën e jashtme në liqen.

## THE WATER GATE

The Water Gate is located southwest of the Great Basilica, right on the shore of the Vivari channel. It was a large and well-fortified entrance, which enabled access to the city through the Vivari channel and Butrint lake. This gate has a square-plan entrance corridor while a tower enabled its protection from side attacks. The Water Gate replaced the Towers Gate of the Hellenistic period and its access would be possible only by boat. This gate dates back to the 6th century AD, but there are also interventions in later phases. The shape of the gate and its orientation gives the possibility of having a small quay on the lake.




## PORTA ME KULLA


Porta me Kulla ndodhet në afërsi të Bazilikës së Madhe pranë rrënojave të ujësllësit antik. Ajo datohet në shek. III para Krishtit. Kjo portë përbëhet nga dy kulla; një kullë katërkëndore në anën perëndimore dhe një kullë në formë patkoi në anën lindore. Të dyja kullat kanë qenë në lartësinë e dy kateve dhe hapësira e tyre e brendshme ndahej në dy ambiente për rojet.

## THE TOWERS GATE

The Towers Gate is in proximity of the Great Basilica, close to the remains of the ancient aqueduct. It dates to the 3rd century BC. This gate is protected by two towers; a rectangular tower in the western side and a horseshoe-shaped tower in the eastern side. Both towers had two floors and were internally divided in two rooms dedicated to the guards. The eastern



Kulla lindore (në formë patkoi) është e projektuar e tillë që të arrihej goditja e sulmuesve të mundshëm në anën e tyre të pambrojtur. Nga ana tjetër, pas kullës katërkëndërore ndodhej një portë sulmi. Midis dy kullave ndodhej korridori i hyrjes me gjerësi 1.6m dhe gjatësi 7m, përmasa që mundësonin kalimin e karrocave hyrëse e dalëse në qytet si dhe sigurinë e qytetit.



tower is designed in such a way to enable the neutralisation of potential attackers on their weak side. On the other side, behind the rectangular tower there was also a smaller gate for side attacks. The entrance corridor, located between the two towers, had a width of 1.6m and a length of 7m, dimensions which enabled the passage of carts in the city and also assured the city's security.



### PORTA PERËNDIMORE

Porta Perëndimore ndodhet përballë rripit të tokës që lidh kodrën me kreshtën dhe mund të jetë hyrja kryesore nga toka. Kjo hyrje fillimisht duhet të ketë patur një portë me dy kanate. Ajo është ndërtuar gjatë periudhës Helenistike, ndërsa gjatë periudhës së Mesjetës është përforcuar me mure dhe me porta të tjera për të siguruar një hyrje sa më të mbrojtur për në Akropol. Në këtë hyrje nuk është e qartë se çfarë zgjidhjeje konstruktive dhe forme arkitektonike mund t’i kenë dhënë ndërtuesit mbulesës, mbasi punimet e periudhave pasuese ia kanë ndryshuar mjaft pamjen origjinale. Megjithatë, duke patur një planimetri ballore ajo mund të ketë patur ngjashmëri me Portën e Luanit dhe Portën Skea, ndërsa gjatësia e udhëkalimit mund të ketë qenë jo më shumë se 2.7m.

### THE WESTERN GATE

The West gate is located in front of the land strip that connects the hill with the ridge and may be the main entrance from the land. This entrance must have originally had a pair of two doors. The gate is built during the Hellenistic period, and it was further fortified with walls and other gates during the Middle Ages to provide a more secure entrance to the Acropolis. In this entrance it remains unknown the kind of constructive solution and architectural form the master builders may have given to the roof, due to the fact that the works of the following periods have altered the original appearance. However, the plan is frontal and may have been similar to the Lion Gate and the Scaean Gate. The length of the passage may have not exceeded 2.7m distance.

### TË DHËNAT MBI BOTIMIN

**Copyright**  
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore  
Parku Kombëtar Butrint  
Tiranë 2020  
**Dizajni dhe faqosja**  
Shtypshkronja “Kristalina.KH”  
**Përgatiti tekstin mbi përshkrimin historik të Butrintit**  
Era Bushi Xhaferaj  
**Përzgjedhi dhe përgatiti tekstin mbi portat monumentale**  
Eva Thomagjini  
**Fotografitë e portave**  
Eva Thomagjini  
**Redaktoi materialin dhe koordinoi realizimin**  
Marsela Plyku Demaj  
Klodjana Gjata  
Renald Meta  
**Për më shumë informacion mbi projektin Mo.Na**  
<https://www.monumentnature.com/>


### INFORMATION ON THE PUBLICATION

**Copyright**  
National Institute for Cultural Heritage  
National Park of Butrint  
Tirana 2020  
**Design**  
Printing House “Kristalina.KH”  
**Prepared the text of the historical overview of Butrint**  
Era Bushi Xhaferaj  
**Selected and prepared the text on monumental gates**  
Eva Thomagjini  
**Photos of the gates**  
Eva Thomagjini  
**Proof printing of the material and coordination**  
Marsela Plyku Demaj  
Klodjana Gjata  
Renald Meta  
**For more information on Mo.Na Project**  
<https://www.monumentnature.com/>

# Interreg



Balkan-Mediterranean  
Mo.Na



Mo.Na Monuments in Nature

*We built shrines of worship  
and castles on top of the hills  
we carved stones, we built theaters  
we made ports, roads, dams and aqueducts  
the monuments of human civilization  
will always exist to remind us  
that nature will always exist for us  
challenging our urge to create culture.*



Nature and monuments are silent  
#Be their voice